

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të  
Brendshëm  
Internal Audit Practice**

**B3**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 13/02/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Një auditor po kryen një auditim operacional të një divizioni dhe vëren se një sasi jashtëzakonisht e madhe mallrash është në dispozicion në zonat e transportit dhe ripërpunimit të materialeve. Artikujt janë etiketuar si artikuj për ri-dërgim. Pas hetimit, auditorit i thuhet se ato janë mallra që janë kthyer nga klientët dhe, ose janë riparuar, ose janë dërguar përsëri te klienti origjinal, ose janë riparuar dhe dërguar si produkte të reja sepse janë plotësisht të garantuara.  
Supozoni se auditori zbuloi se shumica e mallrave ishin riparuar dhe shitur si artikuj të rinj. Shitjet e tilla janë kundër politikës së kompanisë dhe kundër rregulloreve të bëra nga ana e qeverisë. Auditori nuk e di nëse ishte përfshirë mashtrim apo masën në të cilën menaxhmenti i divizionit ishte përfshirë në skemë. Auditori duhet t'i raportojë gjetjet:
  - A. Vetëm menaxhmentit të divizionit, pasi ata janë përgjegjës për korrigjimin e problemit.
  - B. Menaxhmentit të divizionit dhe organeve përkatëse rregullatore, pasi është një shkelje e qartë e rregulloreve qeveritare.
  - C. Menaxhmentit të divizionit, komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të lartë.**
  - D. Vetëm komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të lartë.
2. Drejtori i auditimit të brendshëm është i shqetësuar se një mashtrim i zbuluar së fundmi nuk u zbulua gjatë auditimit të fundit të operacioneve të parasë së gatshme. Një rishikim i dokumenteve të punës tregoi se transaksioni mashtrues nuk ishte përfshirë në një mostër statistikore të dizajnuar siç duhet të transaksioneve të testuara. Cila nga pohimet në vijim vlen për këtë situatë?
  - A. Për shkak se operacionet me para të gatshme janë një zonë me rrezik të lartë, duhet të ishte kryer testimi 100% i transaksioneve.
  - B. Auditori i brendshëm ka vepruar me kujdes të duhur profesional pasi që është testuar një mostër e përshtatshme statistikore e transaksioneve materiale.**
  - C. Mashtrimi nuk do të duhej të kishte mbetur i pazbuluar në një zonë të audituar së fundmi.
  - D. Kujdes i jashtëzakonshëm është i nevojshëm në kryerjen e një auditimi të operacioneve me para dhe auditori duhet të mbahet përgjegjës për gabimin.
3. Gjatë punës së tyre, auditorët e brendshëm duhet të jenë vigjilentë për mashtrime dhe forma të tjera të krimeve këmishë-bardha. Karakteristika e rëndësishme që dallon mashtrimin nga llojet e tjera të krimeve këmishë-bardha është se:
  - A. Mashtrimi përfshin një sërë parregullsish dhe veprimesh të paligjshme që përfshijnë mashtrim të qëllimshëm.**
  - B. Ndryshe nga krimet e tjera këmishë-bardha, mashtrimi kryhet gjithmonë kundër një pale të jashtme.
  - C. Krimi këmishë-bardhë zakonisht kryhet për të mirën e një organizate, ndërsa nga mashtrimi përfiton një individ.
  - D. Të huajt zakonisht kryejnë krime këmishë-bardhë në dëm të një organizate, ndërsa personat e brendshëm kryejnë mashtrime për të përfituar organizata.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

4. Auditimi i brendshëm është përgjegjës për të ndihmuar në parandalimin e mashtrimit duke:
  - A. Informuar autoritetet përkatëse brenda organizatës dhe duke rekomanduar çfarëdo hetimi që konsiderohet i nevojshëm në rrethanat kur dyshohet për keq-bërje.
  - B. Krijuar sisteme të dizajnuara për të siguruar përputhshmëri me politikën, planet dhe procedurat e organizatës, si dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
  - C. Ekzaminuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit, në përpjesëtim të drejtë me shtrirjen e ekspozimit/rrezikut të mundshëm në segmente të ndryshme të operacioneve të organizatës.**
  - D. Përcaktuar nëse standardet e operimit janë krijuar për të matur ekonominë dhe efikasitetin dhe nëse këto standarde janë kuptuar dhe janë duke u përmbushur.
  
5. Një auditor i brendshëm i raportoi drejtorit të auditimit të brendshëm për një dyshim për mashtrim. Drejtori ia dorëzoi rastin departamentit të sigurisë. Departamenti i sigurisë nuk arriti të hetojë dhe raportojë rastin të menaxhmenti. Autori i mashtrimit vazhdoi të mashtronte organizatën derisa u zbulua aksidentalisht nga një menaxher dy vjet më vonë. Zgjidhni veprimin më të përshtatshëm për drejtorin e auditimit.
  - A. Veprimet e drejtorit të auditimit të brendshëm ishin të sakta.
  - B. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet të kishte kontrolluar periodikisht gjendjen e rastit të mashtrimit me departamentin e sigurisë.**
  - C. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet të kishte kryer hetimin.
  - D. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet ta kishte shkarkuar autorin e mashtrimit.
  
6. Sipas Standardeve të Institutit të Auditorëve të Brendshëm, roli i auditimit të brendshëm në hetimin e mashtrimit përfshin të gjitha pohimet në vijim, përveç:
  - A. Vlerësimit të nivelit të mundshëm dhe masës së bashkëpunimit në mashtrim brenda organizatës.
  - B. Hartimit të procedurave që duhen ndjekur në përpjekje për të identifikuar autorët, shtrirjen e mashtrimit, teknikat e përdorura dhe shkakun e mashtrimit.
  - C. Koordinimin e aktiviteteve me personelin drejtues, këshilltarin ligjor dhe specialistë të tjerë të përshtatshëm gjatë gjithë hetimit.
  - D. Marrjes në pyetje të autorëve të dyshuar për mashtrim.**
  
7. Përcaktimi i kursimeve të kostos duke u fokusuar në ekonomi dhe efikasitet ka shumë të ngjarë të jetë një objektiv i:
  - A. Auditimit të kujdesit të duhur
  - B. Auditimit financiar.
  - C. Auditimit të përputhshmërisë.
  - D. Auditimit operacional.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

8. Gjatë një auditimi operacional, auditori krahason personelin aktual të një departamenti me standardet e vendosura të industrisë në mënyrë që të:
  - A. Identifikoj punonjësit fiktiv në listën e pagave të departamentit.
  - B. Vlerësoj performancën aktuale të departamentit dhe të jap rekomandimet e duhura për përmirësim.**
  - C. Vlerësoj përshatshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura për departamentin.
  - D. Përcaktoj nëse departamenti ka respektuar të gjitha ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me personelin e tij.
  
9. Një firmë prodhuese përdor sasi të mëdha artikujsh të vegjël dh të lirë, të tilla si bulonat me dado (elemente lidhëse mes dy materialeve), në procesin e prodhimit. Ndërsa këto mallra blihen, ato regjistrohen në stoke në sasi të mëdha. Koshat janë të vendosur në katin e dyqanit për të siguruar çasje në kohë në këto artikuj. Kur është e nevojshme, koshat rimbushen nga stoqet dhe kostoja e artikujve të vegjël ngarkohet në një llogari të furnizimeve të konsumueshme, e cila është pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të dyqanit. Cila nga veprimet në vijim do të siguronte kontroll mbi nivelin e shpenzimeve për artikujt e vegjël material?
  - A. Të zhvendosen koshat në depon e stoqeve.
  - B. Të kërkohen rishikim i shpenzimeve nga menaxhmenti mbi koston e artikujve të vegjël të përdorur në raport me buxhetin.**
  - C. Të mbyllen koshat gjatë orarit normal të punës.
  - D. Asnjë nga kontrollet e mësipërme nuk nevojitet për artikujt me kosto dhe madhësi të vogël.
  
10. Cila nga pohimet në vijim përshkruan një dobësi kontrolli?
  - A. Procedurat e blerjes janë të dizajnuara mirë dhe ndiqen përveç nëse nuk udhëzohet ndryshe nga mbikëqyrësi i blerjes.**
  - B. Urdhrat e blerjeve bosh/zbrazëta të para numëruara sigurohen brenda departamentit të blerjeve.
  - C. Blerjet normale operationale bien në rangun nga €500 në €1,000, me dy nënshkrime të nevojshme për blerjet mbi €1,000.
  - D. Agjenti i blerjeve investon në një fond të përbashkët të tregtuar publikisht që liston në portofolin e tij aksionet e një prej furnizuesve të kompanisë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

11. Kur një kompani që shet furnizime për zyra nuk është në gjendje të kompletoj plotësisht një porosi, ajo shënon artikujt që nuk-ka-në-stoqe si të artikujt të porositur në porosinë e klientit dhe i fut këta artikujt në një skedar të artikujve-me-porosi që menaxhmenti mund ta shikojë ose printojë. Konsumatorët janë të pakënaqur me kompaninë sepse duket se ajo nuk është në gjendje të mbajë shënimet dhe të dërgojë artikujt që nuk janë në stok sapo të jenë të disponueshme. Qasja më e mirë për të siguruar shpërndarjen e shpejtë të artikujve që nuk janë në stoqe është:
- A. Përputhni skedarin e artikujve-me-porosisë me mallrat e pranuar çdo ditë.**
  - B. Rritni sasinë e stoqeve për të minimizuar numrin e herëve që ndodhin artikujt të mos jenë në stoqe.
  - C. Zbatoni shkëmbimin elektronik të të dhënave me furnitorët për të zvogëluar kohën për të rimbushur stoqet.
  - D. Barazoni shumën e porosive të kompletuara dhe të artikujve me porosi, me totalin e të gjitha porosive të bëra çdo ditë.
12. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më pak efektive në përcaktimin nëse një divizion regjistroi shitjet e vitit të kaluar në vitin aktual?
- A. Kryeni procedura të rishikimit analitik që krahasojnë shitjet mujore për dy vitet e fundit, duke përfshirë muajt para dhe pas fundit të vitit.
  - B. Konfirmoni shumën e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit me klientët kryesorë.
  - C. Përdorni një strukturë të integruar për testim (ITF) për të ekzekutuar të dhëna përmes kompjuterit gjatë muajit të fundit të vitit të kaluar dhe muajit të parë të vitit pasardhës për të përcaktuar nëse shitjet janë regjistruar saktë.**
  - D. Kryeni një rishikim analitik duke krahasuar vëllimin për njësi të produkteve kryesore të dërguara gjatë muajit të fundit të vitit dhe muajit të parë të vitit pasardhës.
13. Një auditor i brendshëm po auditon llogaritë e një divizioni dhe është i shqetësuar se menaxhmenti i divizionit mund të ketë dërguar mallra me cilësi të dobët në mënyrë që të rrisë shitjet dhe përfitimin për vitin dhe në këtë mënyrë të rrisë bonusin e menaxherit të divizionit. Për më tepër, auditori dyshon se mallrat e kthyer po u dërgohen klientëve të tjerë si produkte të reja pa u korrigjuar plotësisht defektet. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më pak efektive për të përcaktuar nëse dërgesa të tilla kanë ndodhur?
- A. Kontrollimi i kredit notave të lëshuara pas fundit të vitit për mallrat e dërguara para fundit të vitit.
  - B. Vëzhgimi fizik i zonës së transportimit të mallrave dhe pranimit të mallrave për dëshmi të mallrave të kthyer.
  - C. Intervistimi i përfaqësuesit të shërbimit për klient në lidhje me sasinë e ankesave të pazakonta të klientëve.
  - D. Kërkoni që divizioni të bëjë një numërim fizik të plotë të stoqeve në fund të vitit dhe vëzhgoni numërimin e stoqeve.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

14. Auditori i brendshëm i një kompanie është caktuar të kryejë një auditim të aktiviteteve investuese të kompanisë me theks të veçantë në përdorimin e instrumenteve të reja financiare nga kompania të referuara si derivate. Një menaxher i portofolit të investimeve ka autorizimin të përdorë derivatet financiare për të mbrojtur transaksionet, por nuk supozohet të marrë pozicione spekulative. Megjithatë, menaxheri përdor një skemë që përfshin (1) marrjen e një pozicioni më të madh se sa kërkohet për të mbrojtur transaksionet, (2) vendosjen e fitimeve spekulative në një llogari pezull dhe (3) transferimin e fondeve të një ndërmjetës jo-ekzistuese dhe prej andej në një llogari personale. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më pak efektive në zbulimin e këtij mashtrimi?

**A. Kontrolloni tregtimet individuale për të përcaktuar nëse tregtimet shkelin kufirin e autorizimit për menaxherin.**

B. Merrni mostra të tregtimeve individuale dhe përcaktoni përputhjen e saktë të një mbrojtjeje të transaksioneve. Planifikoni dhe hetoni të gjitha ndryshimet.

C. Merrni mostra të të gjitha debiteve në llogarinë pezull dhe shqyrtoni natyrën e tyre.

D. Merrni mostra të transfereve të fondeve të ndërmjetësit/brokerët dhe përcaktoni nëse ndërmjetësit janë në listën e autorizuar për transaksionet e kompanisë.

15. Një auditor i brendshëm po kontrollon një divizion të prodhimit menjëherë pas mbylljes së vitit fiskal. Secila pyetje përbëhet nga një procedurë specifike auditimi dhe një zgjedhje e katër gjetjeve të ndryshme të auditimit. Cila nga gabimet ose praktikat e dyshimta ka më shumë gjasa të zbulohet nga procedura e specifikuar e auditimit? *'Në datat e zgjedhura rastësisht, gjatë muajit pas fundit të vitit fiskal, kontrollohen të gjitha faturat e shpenzimeve të paregjistruara.'*

A. Shitjet janë të mbivlerësuara për muajin aktual.

B. Shpenzimet janë të mbivlerësuara për vitin fiskal që sapo ka përfunduar.

**C. Llogaritë e pagueshme janë të nënvlerësuara në fund të vitit fiskal (një muaj më parë).**

D. Llogaritë e pagueshme janë të mbivlerësuara në fund të vitit fiskal (një muaj më parë).

16. Cila nga aktivitetet e mëposhtme përfaqëson një funksion të përshtatshëm të departamentit të burimeve njerëzore dhe një pengesë për mashtrim në listën e pagave?

A. Shpërndarja e çeqeve të pagave.

B. Autorizimi i punës jashtë orarit.

**C. Autorizimi i shtesave dhe largimeve në listën e pagave.**

D. Mbledhja dhe mbajtja e pagesave të padeklaruar.

17. Mbajtja e një skedari të urdhrave të blerjeve në departamentin për pranimin e mallrave, për mallrat e porositura, por që nuk janë marrë ende, ndihmon për të siguruar që:

A. Mallrat dorëzohen në departamentin përkatës në kohën e duhur.

**B. Pranohen vetëm blerjet e autorizuara.**

C. Mallrat numërohen siç duhet kur arrijnë.

D. Mallrat e pranuar nuk përvetësohen.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

18. Në një përpjekje për të mbetur konkurrues, një kompani autorizoi departamentin e shitjeve për të ulur çmimet dhe për të përmirësuar operacionet. Duke lejuar personelin individual të shitjeve të miratojë kreditimin dhe të përcaktojë disponueshmërinë dhe shpërndarjen e produktit, shitjet u rritën. Pas këtyre ndryshimeve, shlyerjet e llogarive të arkëtueshme të papaguara u rritën. Një veprim korrigjues i duhur është:
- A. Një rishikim dhe miratim i pavarur i kreditimit të shitjeve.**
  - B. Një përcaktim i pavarur i disponueshmërisë së produktit.
  - C. Centralizimi i kontrollit të menaxhimit.
  - D. Një rritje në marzhet e fitimit.
19. Një auditor po vëzhgon shitjet në para të gatshme për të përcaktuar nëse klientëve u jepen fatura. Qëllimi i këtij testi është të sigurojë që:
- A. Paraja e pranuar është e barabartë me totalin e arkëttimeve.
  - B. Klientët ngarkohen me çmime të autorizuara.
  - C. Saldot e parave të gatshme janë të sakta.
  - D. Të gjitha shitjet në para të gatshme regjistrohen.**
20. Cila nga deklaratat e mëposhtme është një objektiv auditimi?
- A. Vëzhgoni depozitimin e parave të gatshme të pranuar.
  - B. Analizoni modelin e çfarëdo mungese të parave.
  - C. Vlerësoni nëse arkëtimet e parave të gatshme janë të mbrojtura në mënyrë adekuate.**
  - D. Rillogaritni çdo muaj rakordimin bankar.
21. Për të minimizuar rrezikun që agjentët në departamentin e blerjeve të përdorin pozitën e tyre për përfitime personale, organizata duhet:
- A. Qarkulloni periodikisht detyrat e agjentëve të blerjeve.**
  - B. Kërkoni nga auditorët e brendshëm të konfirmojnë blerjen e zgjedhur dhe llogarinë e pagueshme.
  - C. Specifikoni që të gjithë artikujt e blerë duhet të kalojnë rishikimin e vlerës për njësi të kostove.
  - D. Kërkoni nga departamenti i blerjeve që të mbajë shënime mbi çmimet e paguara të blerjeve, dhe rishikoni çmimet e paguara të blerjeve çdo gjashtë muaj.
22. Cili nga kontrollet e mëposhtme do të ndihmonte në parandalimin e mbi pagimit të një furnitori?
- A. Rishikimi dhe anulimi i dokumenteve mbështetëse për të cilat është lëshuar një çek.**
  - B. Kërkohet që nënshkruesi i çekut t'ia dërgojë çekun direkt furnitorit.
  - C. Rishikimi i shpërndarjes kontabël për shpenzimet.
  - D. Miratimi i blerjes përpara se të dërgohet porosia tek furnitori.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

23. Programet e auditimit që testojnë kontrollet e brendshme duhet:
- A. Të jenë të përgjithësuara në mënyrë që të jenë të përdorshme në të gjitha pjesët e një departamenti të veçantë.
  - B. Të reduktojnë dyfishimin e përpjekjeve dhe të kostove përkatëse duke siguruar që të kontrollohet çdo aspekt i operacioneve.
  - C. Të jenë të përgjithësuar për t'iu përshtatur të gjitha situatave pa marrë parasysh linjat e departamenteve.
  - D. Të jenë të përshtatshëm për auditimin e secilit operacion.**
24. Një auditor i brendshëm ka shumë të ngjarë të gjejë një anomali të jetë materiale në një bilanc të llogarisë nëse anomalia përfshin një:
- A. Përqindje të lartë të ardhurave neto.**
  - B. Transaksion të pazakontë për kompaninë.
  - C. Transaksion rutinë të pa verifikuar.
  - D. Gabimi të kontabilistit që nuk ka gjasa të ndodhë përsëri.
25. Një auditor i brendshëm zbuloi një anomali në llogari të arkëtueshme me një aksionari me shumicë votash në kompani. Shuma e bilancit të arkëtueshmërisë nga aksionari është më pak se 1% të totalit të arkëtimit të kompanisë. A ka të ngjarë që auditori ta konsiderojë anomalinë si materiale?
- A. Po, nëse rreziku relativ është i ulët.
  - B. Po, sepse është e përfshirë një palë e lidhur.**
  - C. Jo, nëse do të ketë transaksione të mëtejshme me këtë mbajtës të aksioneve.
  - D. Jo, sepse është shumë e vogël monetare me anomali.
26. Auditorët e brendshëm shpesh përfshijnë përmbledhje brenda letrave të tyre të punës. Cila nga se vijojnë përshkruan më së miri qëllimin e përmbledhjeve të tilla?
- A. Përmbledhjet zakonisht kërkohen për plotësimin e secilit seksion të një programi të auditimit.
  - B. Përmbledhjet nxjerrin informacionin më të dobishëm nga disa letra pune në një formë më të përdorshme.**
  - C. Përmbledhjet përdoren për të dokumentuar faktin që auditori ka marrë parasysh të gjitha evidencat përkatëse.
  - D. Përmbledhjet janë përgatitur të jenë në përputhje me Standardet e IAB/IIA.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

27. Ju jeni një mbikëqyrës i auditimit, duke rishikuar letrat e punës të një stafi të auditimit për një auditim të përgjithshëm të funksionit të shitjeve të firmës. Letrat e punës nuk janë të referuara. Për më tepër, letrat e punës ranë në tokë dhe u grumbulluan rastësisht përpara se t'ju sillnin. Ju vendosët t'i rendisni letrat e punës në rendin e duhur sipas Standardeve të IAB/IIA. Faza e parë e këtij aktiviteti është identifikimi i secilës faqe si pjesë e (1) anketës paraprake, (2) rishikimit të përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, (3) rishikimit për efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm ose (4) rishikimit për cilësinë e performancës.

Letra e parë që ju zgjodhët dokumentonte një test pajtueshmërie të kryer gjatë kontrollit. Kjo faqe i përket cilit aktivitet:

- A. Anketimit paraprak
- B. Rishikimit për përshtatshmërinë e sistemit.
- C. Rishikimit për efektivitetin e sistemit.**
- D. Rishikimit për cilësinë e performancës.

28. Një zjarr i fundit në depon e një kompanie ka shkatërruar një pjesë të madhe të stoqeve të saj. Menaxhmenti është në proces të paraqitjes së një kërkesë për rimbursim nga kompania e sigurimit dhe duhet të përdorë letrat e punës të auditorëve të brendshëm për stoqet në përgatitjen e kërkesës. Sipas Standardeve të IIA, cila nga pohimet është e saktë?

- A. Menaxhmenti mund të përdorë dokumentet e punës të auditorëve të brendshëm për stoqet në përgatitjen e kërkesës për rimbursim nga kompania e sigurimit, por drejtori i auditimit të brendshëm duhet të aprovojë një përdorim të tillë.**
- B. Menaxhmenti mund të përdorë dokumentet e punës të auditorëve të brendshëm për stoqet në përgatitjen e kërkesës për rimbursim nga kompania e sigurimit, por të dy, auditorët e pavarur të jashtëm të kompanisë dhe drejtori i auditimit të brendshëm duhet të aprovojnë një përdorim të tillë.
- C. Menaxhmenti duhet të largohet nga përgatitja e kërkesës për rimbursim nga kompania e sigurimit, dhe një funksion i tillë duhet t'i jepet departamentit të auditimit të brendshëm.
- D. Menaxhmenti nuk mund të përdorë asnjë nga dokumentet e punës të auditorëve të brendshëm në përgatitjen e kërkesës për kompaninë e sigurimit.

29. Disa nivele të menaxhmentit janë të interesuar në rezultatet e auditimit të departamentit të marketingut. Cila është metoda më e mirë e komunikimit të rezultateve të auditimit?

- A. Shkruaj raporte të hollësishme për secilin nivel të menaxhmentit.
- B. Diskutoni rezultatet me të gjitha nivelet e menaxhmentit.
- C. Diskutoni rezultatet me menaxhmentin e marketingut dhe lëshoni një raport përmbledhës për menaxhmentin e lartë.
- D. Shkruani një raport për menaxhmentin e marketingut dhe jepni raporte përmbledhëse niveleve tjera të menaxhmentit.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

30. Informacioni i mëposhtëm është marrë nga një draft i një raporti auditimi të përgatitur pas përfundimit të auditimit të procedurave të deponimit të stoqeve të një divizioni.

Gjetjet

[# 5]

Ne kemi kryer teste të gjera të mbajtjes së regjistrave të stoqeve dhe sasive në dispozicion. Bazuar në testet tona, ne kemi arritur në përfundimin se divizioni mbart një sasi të madhe të stoqeve të tepërta, veçanërisht në fushën e pjesëve përbërëse. Ne presim që kjo të jetë për shkak të konservatorizmit të menaxhmentit lokal që nuk dëshiron të rrezikojë ndërprerjen e prodhimit nëse mallrat nuk janë në dispozicion. Sidoqoftë, siç u vu re më herët në këtë raport, stoqet e tepërta kanë çuar në një shkallë më të lartë se mesataret e stoqeve të vjetruar në këtë divizion. Ne rekomandojmë që të vendosen parashikimet e prodhimit, së bashku me kohën e prodhimit për produkte të ndryshme, dhe të përdoren në lidhje me konceptet e sasisë së rendit ekonomik për të porositur dhe ruajtur nivelet e duhura të stoqeve.

[# 6]

Ne vërejtëm se raportet e pranimit nuk ishin plotësuar kur departamenti i pranimit ishte i zënë. Në vend të kësaj, menaxheri pranues do të plotësonte raportet pas punës dhe do t'i dërgonte ato në departamentin e llogarive të pagueshme. Ekziston rreziku që të gjithë artikujt e marrë mund të mos regjistrohen ose që mos regjistrimi fillestar mund të rezultojë që disa artikuj të dërgohen në vende të tjera. Gjatë testeve tona, ne kemi vërejtur shumë raste në të cilat departamenti i llogarive të pagueshme duhej të thërrisnin për të marrë një raport pranimi. Ne rekomandojmë që raportet e pranimit të përgatiten.

[# 7]

Stoqet janë të çrregullta. Ne rekomandojmë që menaxhmenti të komunikojë rëndësinë e teknikave të rregullta të administrimit të stoqeve për personelin e magazinës për të shmangur problemet e përmendura më herët në lidhje me (1) gjetjen e stoqeve kur është e nevojshme për prodhim dhe (2) ndodhjen e shlyerjeve të shumave të mëdha të pazakonta të stoqeve për shkak të vjetërsimit.

[# 8]

Ne e vlerësojmë bashkëpunimin e menaxhmentit të divizioneve. Ne synojmë të diskutojmë gjetjet tona me ta dhe të përcjellim reagimin tuaj ndaj rekomandimeve të përfshira në këtë raport. Duke pasur parasysh kohën shtesë për analizë, ne mendojmë se ka mundësi të konsiderueshme në dispozicion për kursime të konsiderueshme të kostos dhe jemi krenarë që jemi pjesë e procesit.

Një mangësi e madhe në paragrafin # 8 është:

- I. Natyra e veprimit vijues është e papërshtatshme.
- II. Gjetjet nuk janë diskutuar me menaxhmentin e divizionit para se ato t'i prezantohen menaxhmentit të lartë.
- III. Kursimet e përmendura të kostos nuk janë mbështetur në raport.

A. Vetëm I

B. Vetëm II

C. Vetëm III

**D. I, II dhe III**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

31. Informatat e mëposhtme janë në dispozicion nga pasqyrat financiare të një departamenti prodhues. Drejtori i auditimit të brendshëm është duke rishikuar të dhënat për të identifikuar rreziqet e mundshme si bazë për planifikimin e auditimit. Departamenti nuk është audituar nga departamenti i auditimit të brendshëm në tri vitet e fundit. Departamenti zhvillon pjesën më të madhe të biznesit të tij në mënyrë autonome. Departamenti historikisht është mbështetur në një produkt kryesor. Sidoqoftë, ai produkt po moshohet dhe së shpejti do të humbasë mbrojtjen e patentës.

Koeficientët	Viti aktual 2021	Viti i kaluar 2020	Viti paraprak 2019	Mesatarja e industrisë
Koeficienti i qarkullimit	1.94	1.89	2.28	2.13
Koeficienti i shpejt	0.66	0.88	1.22	1.4
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	112	93	72	69
Periudha e qarkullimit të stoqeve	148	167	92	73
KMSH si % e shitjeve	0.375	0.402	0.412	0.445
Shitjet / pasuritë e prekshme	2.89	2.58	2.53	3.01
Shitjet / gjithsej pasuritë	1.33	1.31	2.53	2.78
Rritja e shitjeve	0.03	0.16	0.02	0.045
Fitimi neto ('000)	(€7,600)	€985	(€1,200)	€4,500

Koeficienti i qarkullimit është rritur në krahasim me vitin e kaluar ndërsa koeficienti i shpejtë u ul. Cili nga shpjegimet e mëposhtme do të shpjegonte më së miri arsyen pse koeficienti i qarkullimit u rrit ndërsa koeficienti i shpejtë u ul?

- A. Një rritje e konsiderueshme e llogarive të pagueshme që ndikojnë në koeficientin e qarkullimit por jo në koeficientin e shpejtë.
  - B. Rritja e konsiderueshme e llogarive të arkëtueshme.
  - C. Rritja e konsiderueshme e stoqeve.**
  - D. Rritja e madhe e sasisë së pasurive jo-qarkulluese që ndikon në raportin aktual por jo në raportin e shpejtë.
32. Kur përgatitet një prezantim menaxhmentit, auditori dëshiron të raportojë gjetjet dhe të stimulojë ndërmarrjen e veprimeve sipas rekomandimeve të auditimit. Këto objektiva realizohen më së miri nga:
- A. Ofrimi i një ligjërate për gjetjet.
  - B. Duke treguar një seri sllajdesh që përshkruajnë grafikisht gjetjet; komunikimi verbal i kufizuar.
  - C. Përdorimi i sllajdeve për të mbështetur një diskutim të pikave kryesore.**
  - D. Dorëzimi i kopjeve të raportit, duke u kërkuar pjesëmarrësve të lexojnë raportin dhe të bëjnë pyetje.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

33. Është e rëndësishme që auditori të jetë në gjendje të bëjë dallimin midis një kufizimi të fushës dhe kufizimeve të tjera të auditimit. Sipas Standardeve të IAB/IIA, cili nga sa vijon nuk do të konsiderohej kufizim i fushës?
- Menaxhmenti i një divizioni që po auditohet ka treguar që divizioni është në proces të konvertimit të një sistemi kryesor kompjuterik dhe ka treguar që pjesa e teknologjisë së informacionit që është planifikuar të auditohet do të duhet të shtyhet deri në vitin e ardhshëm.
  - Komiteti i auditimit rishikon planin e auditimit për vitin dhe fshin një auditim që drejtori i auditimit mendoi se ishte i rëndësishëm për të kryer.
  - Pala e audituar ka treguar që disa klientë nuk mund të kontaktohen sepse organizata është në proces të negociimit të një kontrate afatgjatë me ta dhe nuk dëshiron të shqetësojë klientët.
  - Asnjë nga përgjigjet nuk është e saktë.
- A. Vetëm I  
**B. Vetëm II**  
C. Vetëm III  
D. Vetëm IV
34. Përmbledhja e raporteve të shkruara të auditimit, në përgjithësi shkruhen për:
- Menaxhmentin operacional lokal
  - Menaxhmentin e nivelit mesatar.
  - Menaxhmentin e nivelit të lartë dhe/ose komitetin e auditimit.**
  - Për shqyrtim vetëm nga auditorët e tjerë
35. Disa informacione mund të mos jenë të përshtatshme për shpalesje për të gjithë marrësit e raportit sepse ato janë të privilegjuara, pronësore ose të lidhura me akte të pahijshme ose të paligjshme. Nëse kushtet që raportohen përfshijnë veprime të pahijshme të një menaxheri të lartë, raporti duhet të shpërndahet tek:
- Auditori i jashtëm
  - Aksionarët
  - Menaxhmenti i lartë
  - Bordi i drejtorëve**
36. Një rekomandim i raportit të auditimit duhet të adresojë cilën atributit të gjetjes së auditimit?
- Pasqyrën e gjendjes.
  - Kriteret
  - Efektet
  - Shkakun**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

37. Një auditor ka dorëzuar departamentit të audituar një draft të parë të një raporti të auditimit në përgatitje të një interviste dalje. Më poshtë është një fragment nga ai raport:

*Auditimi është kryer për të realizuar disa objektiva: të verifikohet ekzistenca e makinerive të papërdorura që ruhen në depo, të përcaktohet nëse makineritë janë dëmtuar gjatë ruajtjes, të rishikohen procedurat e trajtimit që po kryhen nga personeli në depo, të përcaktohet nëse po ndiqen procedurat e duhura të kontabilitetit për makineri të ruajtura në depo, të llogaritet vlera aktuale e tregut të stotopeve në depo dhe të krahasohet vlera totale e makinerive me regjistrimet kontabël. Është konfirmuar që nga 30 makina të zgjedhura për mostër nga regjistrat e blerjeve, 10 ishin të pranishme në dyshemenë e depove dhe 5 të tjera ishin në dok të gatshëm për përcjellje në objektin e prodhimit. Dymbëdhjetë të tjerët ishin dërguar në objektin e prodhimit më herët. Një ekzaminim i procedurave të kontabilitetit të përdorura në depo zbuloi dështimin e nëpunësit të kontabilitetit të depove për të barazuar të dhënat mujore të stotopeve, siç kërkohet nga politikat. Një mostër prej 25 makinash u ekzaminua për dëmtime të mundshme, dhe të gjitha, përveç njërit ishin në gjendje të mirë. Është konfirmuar nga auditorët se procedurat e trajtimit të përshkruara në manualin e politikave të depove duket se janë adekuate, dhe personeli i depove me sa duket po i ndjek ato procedura, përveç ekzaminimit të artikujve që merreshin për stope.*

Kur komunikoni rezultatet e auditimit, si faktorët e situatës ashtu edhe karakteristikat e mesazheve mund të dëmtojnë procesin e komunikimit. Një auditor ka vetëm kontroll të kufizuar mbi faktorët e situatës, por ka një kontroll thelbësor mbi karakteristikat e mesazheve.

Objektivat e një raporti të auditimit janë të informojnë dhe të ndikojnë. Nëse këto objektiva janë përmbushur varet nga qartësia e shkrimit. Cili nga parimet e mëposhtme të qartësisë së raportit ishte shkelur në raportin e auditimit të mësipërm?

- A. Organizimi i duhur i raportit.
- B. Mbajtja e shumicës së fjalive të shkurtra dhe të thjeshta.
- C. Përdorimi i foljeve aktive.
- D. Të gjitha opsionet e mësipërme.**

38. Nëse një auditor i brendshëm konstaton se nuk është ndërmarrë asnjë veprim korigjues për gjetjet e auditimit paraprak që është akoma i vlefshëm, Standardet e IAB/IIA deklarojnë që auditori i brendshëm duhet:

- A. Përsërisë gjetjet paraprake së bashku me gjetjet e auditimit aktual.
- B. Përcaktoj nëse menaxhmenti ose bordi ka konsideruar rrezikun nga mos ndërmarrja e ndonjë veprim korigjues.**
- C. Kërkoni miratimin e bordit për të filluar veprime korigjuese.
- D. Planifikoni një auditim të ardhshëm të fushës specifike të përfshirë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

39. Një program i sigurimit të cilësisë të departamentit të auditimit të brendshëm ofron siguri të arsyeshme që puna e auditimit përputhet me standardet në fuqi. Cila nga aktivitetet e mëposhtme janë krijuar për të siguruar reagime mbi efektivitetin e një departamenti të auditimit?

- I. Mbikëqyrje e duhur
- II. Trajnime të duhura
- III. Shqyrtime të brendshme
- IV. Shqyrtime të jashtme

- A. I, II dhe III
- B. I, III dhe IV**
- C. I, II, III dhe IV
- D. II, III dhe IV

40. Cila nga aktivitetet e mëposhtme NUK përbën mbikëqyrje të auditimit?

- A. Përgatitja e një programi paraprak të auditimit.**
- B. Sigurimi i udhëzuesve të duhur për auditorët.
- C. Rishikimi i letrave të punës të auditimit.
- D. Duke parë që objektivat e auditimit janë arritur.

41. Sipas Standardeve të IIA, raportet e veprimtarisë së një departamenti të auditimit të brendshëm duhet:

- A. Rendisin gjetjet materiale të auditimeve kryesore.
- B. Rendisin gjetjet e pazgjidhura.
- C. Raportojnë aktivitetet javore të auditorëve individualë.
- D. Krahasojnë auditimet e përfunduara me auditimet e planifikuara.**

42. Cili nga faktorët e mëposhtëm shërben si një kontribut i drejtpërdrejtë në buxhetin financiar të departamentit të auditimit të brendshëm?

- A. Oraret e punës së auditimit.**
- B. Raportet e aktivitetit.
- C. Efektiviteti i kaluar i departamentit të auditimit të brendshëm në identifikimin e kursimeve të kostos.
- D. Statuti i departamentit të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

43. Drejtori i një departamenti të auditimit të brendshëm të sapoformuar është në proces të hartimit të shkrimit të një statuti zyrtar për departamentin. Cila nga pikat e mëposhtme, në lidhje me efektivitetin operacional të departamentit të auditimit të brendshëm, duhet të përfshihet në statut?
- A. Frekuenca e auditimeve që duhet të kryhen.
  - B. Mënyra me të cilën do të raportohen gjetjet e auditimit.
  - C. Procedurat që auditorët e brendshëm do të përdorin në hetimin dhe raportimin e mashtrimit.
  - D. Qasje e pakufizuar e auditorëve të brendshëm në regjistra, personel dhe vetitë fizike që janë të rëndësishme për kryerjen e auditimeve.**
44. Departamenti i auditimit të brendshëm të një korporate të madhe ka krijuar planin dhe buxhetin e tij të operimit për vitin e ardhshëm. Plani i operimit është i kufizuar në kategoritë e mëposhtme: një listë me përparësi të të gjitha auditimeve, stafi i nevojshëm, një buxhet të detajuar të shpenzimeve dhe datën e fillimit të secilit auditim. Cila nga sa vijon përshkruan më së miri mangësitë kryesore të këtij plani operativ?
- A. Kërkesat nga menaxhmenti për projekte speciale nuk merren parasysh.
  - B. Mundësitë për të arritur përfitimet operative nuk merren parasysh.
  - C. Kriteret e matjes dhe data e synuar të përfundimit nuk janë dhënë.**
  - D. Njohuritë, aftësitë dhe disiplinat që kërkohen për të kryer punë nuk merren parasysh.
45. Ka shumë lloje të mashtrimeve, që përkufizohen vetëm si funksion i shkallës së naivitetit të kryerësve të tyre. Davia dhe autorë të tjerë përkufizojnë disa lloje të mashtrimeve. Cila nga opsionet në vijim përfshinë të gjitha llojet e mashtrimeve sipas Davia dhe autorët e tjerë.
- A. Vjedhjet e pasurive dhe mashtrimet sipas shpeshtësisë (frekuencës)
  - B. Mashtrimet me konspiracion, dhe variacionet e mashtrimeve
  - C. Mashtrimet me konspiracion dhe mashtrimet sipas shpeshtësisë (frekuencës)
  - D. Vjedhjet e pasurive; mashtrimet sipas shpeshtësisë (frekuencës); mashtrimet me konspiracion dhe variacionet e mashtrimeve**
46. Një pagesë mashtruese e duplikuar paraqet cilin lloj të mashtrimeve:
- A. Mashtrimet që përmbajnë konspiracion
  - B. Mashtrimet që duken haptazi në regjistrat kontabël**
  - C. Mashtrimet e fshehura në regjistrat kontabël
  - D. Mashtrimet që nuk janë në regjistrat kontabël
47. Kryerja e auditimeve të brendshme të papritura është shembull i kontrollit:
- A. Parandalues
  - B. Zbulues**
  - C. Rimëkëmbjes
  - D. Drejtues

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

48. Procedura analitike e cila përpiket të identifikojë marrëdhëniet e rëndësishme dhe konsistente midis të dhënave financiare dhe atyre operacionale njihet si:

- A. Teknikat e modelimit**
- B. Analizat e prirjeve
- C. Analizat e koeficienteve
- D. Analizimi i pasqyrave financiare

49. Për të nxjerr në pah mashtrimet dhe gabime ekzaminuesit mund të analizojnë bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet mënyrën më të mirë për të zbuluar mashtrimet.

- A. Të dhënat e pasqyrave financiare të periudhës aktuale mund të krahasohen me rezultatet nga periudhat e mëparshme për të gjetur kështu marrëdhënie të pazakonta.
- B. Të dhënat e pasqyrave financiare të periudhës aktuale mund të krahasohen me informacione të ngjashme nga kompani të tjera, ose me statistikat e industrisë për të gjetur marrëdhënie të pazakonta.
- C. Ekzaminimi i të dhënave në pasqyrat financiare, për të parë nëse ato kanë kuptim ndërsa shqyrtohen në lidhje me të dhënat jo - financiare.**
- D. Asnjëra nga opsionet e mësipërme.

50. Udhëzimet federale mbi dënimet që i jepen organizatave që ka mundësi të gjendjen fajtoje, sanksionohen duke iu kërkuar të paguajnë qindra milionë dollarë në dënime të mundshme, thekson se, disa nga këto sanksione mund të falen ose të kompensohen në rast se organizata është në gjendje të demonstrojë se ka ushtruar kujdesin e duhur para kryerjes së veprës penale. Kujdesi i duhur kërkon që organizata të ketë ndërmarrë disa hapa.

- I. Të ketë krijuar politika të përputhshmërisë të cilat përcaktojnë standardet dhe procedurat.
- II. Të ketë caktuar persona të nivelit të lartë të cilët kanë përgjegjësi të veçantë për të bërë të sigurt se veprohet në përputhje me këto standarde dhe procedura.
- III. Është përdorur kujdesi i duhur për të mos i deleguar autoritet domethënës të pakufizuar individëve të cilët mund të angazhohen në aktivitete të jashtë - ligjshme.
- IV. Të ketë komunikuar standardet dhe procedurat ndaj të gjithë të punësuarve.
- V. Të ketë ndërmarrë hapa të arsyeshme për të arritur përputhshmërinë me standardet.
- VI. Të ketë vënë në zbatim standardet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm disiplinorë.
- VII. Të ketë marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të parandaluar vepra të ngjashme në të ardhmen.

Cila nga opsionet e mëposhtme përfshinë të gjitha hapa që kërkohen të ndërmarr një organizatë për të demonstruar se ka ushtruar kujdesin e duhur?

- A. I,II,IV,VI, VII
- B. I, II,III,V, VII
- C. I, III, IV, V
- D. I, II, III, IV, V, VI, VII**